

AKT – THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ecar" SHPK

Sot ne daten 05.04.2024 , une i nenshkruari :

Sami N K Faza, atësia Najib, amësia Aeda, shtetas palestinez , lindur në GAZA, Shteti i Palestinës (PSE) dhe banues në DURRËS, me adresë Neki Libohova 00690579; Nd. 70; H. 2; Durrës; Durrës; 2002; Durrës, lindur më 01/01/1978, i pajisur me pasaporten Nr.6071601 dhe nr.personal 900484924 leshuar nga autoritetet palestineze, dhe leje qendrimi ne shtetin shqiptar nr.839303806 dhe nr. personal H83101024G,

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", kam vendosur te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "ecar"SHPK .

NENI 1

EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te quhet "ecar"SHPK dhe eshte person juridik shqiptar.
Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti dhe Ligjit 9901 date 14.04.2008, si edhe Ligjit per QKR-se .

NENI 2

SELIA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete seline e saj ne Durres, Rruga Neki Libohova, Nd.70, H.2, Zone Kadastrale 8513, Nr.Pasurie 2/1029+2-54.
Shoqeria mund te krijojë filiale, zyra perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj:
Import-eksport automjetesh.
Shitje- blerje automjetesh.
Dhenie automjetesh me qira.
Post karikimi per makina elektrike.

NENI 4

KAPITALI I SHOQERISE

Sami N K Faza


Kapitali i shoqërisë "ecar" SHPK është 100.000 Leke .

Ky kapital përbehet nga 1 kuote dhe zotërohet në masën 100% ,nga ortakët i vetëm i saj, zoti **Sami N K Faza**.

NENI 5

KOHEZGJATJA E SHOQËRISE

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohore të përcaktuar.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISE

-Asambleja e përgjithshme.

-Administratoret.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

-Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.

-Ndryshimin e statutit.

-Emerimin dhe shkarkimin e administratorëve.

-Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspereve kontabel të autorizuar.

-Përcaktimin e shpërblimeve për administratorin, likuiduesin dhe ekspertin kontabel.

-Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.

-Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit.

-Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.

-Përfaqesimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.

-Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

-Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese.

-Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

ADMINISTRATORET

Administrator i shoqërisë do të jetë zoti Sami N K Faza atësia Najib, amësia Aeda, shtetas palestinez , lindur në GAZA, Shteti i Palestinës (PSE) dhe banues në DURRËS, me adresë Neki Libohova 00690579; Nd. 70; H. 2; Durrës; Durrës; 2002; Durrës, lindur më 01/01/1978, i pajisur me pasaportën Nr.6071601 dhe nr.personal 900484924 leshuar nga autoritetet palestineze, dhe leje qëndrimi në shtetin shqiptar nr.839303806 dhe nr. personal H83101024G, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërteritje të këtij afati.

Sami N K Faza


Administratori mund te shkarkohet ne çdo moment nga asambleja , me shumicë të thjeshte te votave, me kusht që në mbledhje të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.
Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

NENI 7

Shpërndarja e fitimit vjetor të shoqërisë

Pjesa e fitimit që i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme.
Asambleja e Përgjithshme ka kompetencë t'u shpërndajë ortakëve pjesën e fitimit në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.
Po ashtu, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që një pjesë e fitimit vjetor të mos u shpërndahet ortakëve, por këto shuma të përdoren për zmadhimin e kapitalit fillestar apo për qëllime të tjera, të cilat ajo i konsideron të dobishme për shoqërinë.

NENI 8

Prishja e shoqërisë.

Prishja e shoqërisë

Shoqëria prishet :

- a) kur mbaron kohe zgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,
- b) me vendim te asamblese se pergjithshme,
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit,
- ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723 date 3.5.2007 per "QKR",
- d) me vendim te gjykates,
- dh) per arsye te tjera ,te parashikuara ne statut.

NENI 9

Likuidimi i shoqërisë.

Në rast të likuidimit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme emëron një likuidator, i cili administron shoqërinë deri në mbylljen e procesit të likuidimit.
Me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar, pasi janë shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve të shoqërisë, likuidatori shpërndan pjesën e mbetur të pasurisë së shoqërisë ndërmjet ortakëve. Kjo shpërndarje e fundit bëhet në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

Sami N K Ferza


Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj të internetit, si dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.

NENI 10

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë. Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE "ecar" SHPK

Sami N K Faza

Sami N K Faza
